

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET**

**MINISTRISË SË FINANCAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**DHE**

**MINISTRISË SË FINANCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**PËR**

**KRIJIMIN E QENDRËS SË PËRBASHKËT TRAJNUSE**

**Ministria e Financave e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë, (të referuara më poshtë si “Palët”),**

*bazuar në Marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, nënshkruar më 7.9.2012,*

*në kuadër të zbatimit të Memorandumit të Mirëkuptimit për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës, nënshkruar në Tiranë, më 23.3.2015, si dhe takimit të përbashkët të dy ministrave, bërë në Prizren, më 3.7.2015,*

*duke dëshiruar, ngritjen e kompetencës profesionale të punonjësve të administratave tatimore dhe doganore të të dy Palëve, për njohjen dhe zbatimin efikas dhe sa më të një trajtshëm të ligjeve fiskale në këto fusha,*

*me qëllim, ngritjen e kapacitetit profesional të institucioneve fiskale të palëve përmes edukimit të vazhdueshëm të zyrtarëve tatimorë dhe doganorë të të dy palëve dhe shkëmbimit të eksperiencave,*

*duke synuar, rritjen dhe zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet Palëve,*

Palët kanë rënë dakord si më poshtë

**Neni 1  
Qëllimi**

1. Krijimi i Qendrës së Përbashkët të Trajnimeve synon ngritjen e kapacitetit profesional të Institucioneve fiskale të Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Shqipërisë për të arritur:
  - a) rritjen dhe zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet Palëve;
  - b) përmirësimin e kapaciteteve administrative të organeve fiskale për t'u përshtatur me kërkesat që duhen përbushur për anëtarësimin në Bashkimin European;
  - c) këmbimin e lektorëve/trajnerëve, programeve të trajnimit dhe pjesëmarrësve në mënyrë të ndërsjellë përfitimin nga eksperiencat e veçanta të dy administratave.

**Neni 2  
Objektivi**

1. Objektivi i kësaj marrëveshjeje është krijimi i një strukture koordinuese ndërmjet Palëve për:
  - a) vlerësimin e nevojave për trajnim të organeve fiskale të të dy vendeve,
  - b) hartimin e programeve të përbashkëta,

- c) organizimin e këmbimeve të lektorëve/trajnerëve, programeve dhe pjesëmarrësve.

### Neni 3 Përfitimet

1. Palët synojnë një administrim sa më të mirë të sistemeve fiskale dhe pranojnë se ngritja dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore është komponent shumë i qenësishëm.
2. Administratat tatimore dhe doganore të të dy vendeve kanë vullnetin dhe zoterojnë staf të kualifikuar në realizimin e trajnimeve profesionale dhe shkërbimin e përvojave.

### Neni 4 Kërkesat themelore

1. Kërkesat themelore për veprimtarinë e përbashkët trajnuese janë:
  - a) plani strategjik;
  - b) plani i veprimeve operacionale;
  - c) buxheti i nevojshëm për pjesëmarrësit dhe lektorët/trajnerët dhe përballimi i shpenzimeve nga institucionet përkatëse.

### Neni 5

#### Struktura përgjegjëse për koordinimin e veprimtarisë së përbashkët trajnuese

1. Struktura përgjegjëse për koordinimin e veprimtarisë së përbashkët ka në përbërje:
  - a) Nga Republika e Kosovës:
    - përfaqësues nga Ministria e Financave;
    - përfaqësues nga Administrata Tatimore e Kosovës;
    - përfaqësues nga Dogana e Kosovës.
  - b) Nga Republika e Shqipërisë:
    - përfaqësues nga Ministria e Financave;
    - përfaqësues nga Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore;
    - përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të Shqipërisë;
    - përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të Shqipërisë.
2. Struktura përgjegjëse për koordinim mblidhet në mënyrë të alternuar në Shqipëri dhe Kosovë, dy herë në vit, në janar dhe qershor të çdo viti dhe miraton:
  - a) planin strategjik të veprimtarive të përbashkëta;
  - b) planin operacional për realizimin e strategjisë;
  - c) programet e përbashkëta të trajnimit.

3. Përfaqësuesit e Palëve janë bashkëkryesues të takimeve dhe bëjnë njoftimet për takimet e strukturës përgjegjëse.
4. Njoftimi i pozicioneve të punës, emrave dhe të dhënrat e kontakteve të punonjësve që do të jenë në përbërje të strukturës përgjegjëse bëhet me shkresa zyrtare dhe në rrugë elektronike.

**Neni 6**  
**Shpenzimet**

Secila palë bartë të gjitha shpenzimet që lidhen me pjesëmarrësit si: dieta, udhëtime, akomodim, etj., ndërsa shpenzimet që lidhen me organizimin e trajnimit përballohen nga Qendra e Përbashkët Trajnuese.


**Neni 7**

**Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria**

1. Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga Palët dhe lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe
2. Secila Palë, mund të njoftojë palën tjetër me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përfundimin e Marrëveshjes. Përfundimi do të ketë efekt tre muaj pas marrjes së një njoftimi të tillë.
3. Marrëveshja mund të ndryshohet nëpërmjet negociatave dhe miratimit të ndërsjellë të Palëve.

Nënshkruar në Prishtinë, më 3 qershor 2016, në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, ku të dyja tekstet janë njëloj të vlefshme.

**PËR**  
**MINISTRINË E FINANCAVE TË**  
**REPUBLIKËS SË KOSOVËS**



**PËR**  
**MINISTRINË E FINANCAVE TË**  
**REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

